



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.445/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Ferki Xhaferi kryesuese, Adnan Konushevci dhe Faton Ademi anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Gentiana Krasniqi, duke vendosur lidhur me ankesën e subjektit politik Lëvizjes Vetëvendosje (LVV), dega në Fushë Kosovë paraqitur kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, për shkak të vendosjes së posterit në afërsi prej 100 metrave nga ndonjë Qendër e Vendvotimit, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më datë 14.02.2021, në seancën e panelit të mbajtur më datë 15.02.2021, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet e pabazuar ankesa e subjektit politik Lëvizjes Vetëvendosje (LVV), Anr.445/2021 e datës 14.02.2021, me të cilin ka kërkuar që subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës, t'i shqiptohet gjobë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes-vendosjes së posterit të kandidatit të tyre për deputet Hasan Qyqalla, në ditën e votimit në një perimetër më afër se 100 metra distancë nga Qendra e Votimit, në ditën e votimit.

A r s y e t i m

Parashtruesi i ankesës, subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, me datën 14.02.2021, ka parashtruar ankesë në PZAP, me të cilën pretendohet se me datë 14 shkurt 2021 rreth orës 09:30, në afërsi me pak se 100 metra afër Qendrës së Vendvotimit, në fshatin Bardh i Madh Komuna Fushë Kosovë është vendosur baneri me përmbajtje elektorale “Kosovë betimi im” përkatësisht fotografia e kandidatit për deputet nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) z. Hasan Qyqalla. Si dëshmi ankesës i ka bashkangjitur një foto të printuar ku shihet kandidati Hasan Qyqalla me emrin e subjektit dhe numrin e tij për votim.

Më këtë rast pretendohet se një gjë e tillë bie ndesh me nenin 36 par.1, pika b) të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, dhe nenin 8 par.1 pika c) të Rregullës Zgjedhore nr.13/2013 të cilat qartazi parashohin se 24 orë para zgjedhjeve, të gjitha materialet/posteret propagandistike duhet të hiqen ne rast se ndodhen në afërsi prej 100 metrave nga ndonjë Qendër e Vendvotimit.

PZAP-i, në kuptim të nenit 7 par.1 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it e informoi subjektin politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) lidhur me ankesat e paraqitura nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje duke kërkuar që të përgjigjet ndaj ankesës deri më datë 15.02.2021 në ora 08:30.

Sipas afatit të caktuar, PZAP- i me datë 15.02.2021 mori përgjigjen e kërkuar nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) i cili subjekt në përgjigjen në ankesë e ka kundërshtuar si të pabazuar ankesën e parashtruar nga ana e subjektit politik Vetëvendosje me arsyet se baneri me përmbajtje elektorale “ Kosovë betimi im” nga kandidati për deputet Hasan Qyqalla është i vendosur në pronë private – shtëpinë e tij dhe sipas fotos- provë të bashkangjitur askund edhe për asnjë moment nuk argumentohet që është ndonjë shkollë afër, për më tepër është një gardh shtëpie në formë muri dhe në atë shtëpi që shihet që është pronë private e vet kandidatit është i vendosur baneri i tillë. Si të tillë ankesën e subjektit politik Vetëvendosje e vlerëson si jo të plotë, jo mirë të argumentuar dhe fotoja nuk provon asgjë konkrete, pra baneri i tillë nuk provon se shkolla në fshatin Bardh i Madh gjendet në afërsi. Megjithatë këto arsye z. Hasan Qyqalla ani pse banerin e vendosur edhe pse statik e ka në shtëpinë e tij private e ka larguar nga ky vend për ka edhe e ka bashkangjitur foton si dëshmi dhe pretendimi i subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje se vendi gjendet pranë shkollës është në kundërshtim me nenin 33 pika k) prandaj mbi këto arsye i ka propozuar PZAP-së që ankesën e paraqitur nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje ta hudhë poshtë si të pabazuar.

PZAP-i, pas shqyrtimit paraprak të bazueshmerisë së ankesës dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore si dhe provave materiale-fotografit, të bashkangjitura, që gjenden në shkresat e lëndës, në kuptim të nenin 117 par.2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

Nuk është kontestues fakti se përmes fotografisë së dërguar si provë vërehet poster i kandidatit për deputet nga Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) Hasan Qyqalla, i vendosur në rrethojën e një shtëpie.

Paneli vlerëson se në bazë të fotografisë së prezantuar si provë materiale, e cila gjendet në shkresat e lëndës, nuk mund të konstatohet qartë dhe bindshëm siç përcaktohet me nenin 117 par. 3 të LZP-së, për të provuar se shkelësi i supozuar ka shkelur Kodin e Mirësjelljes, ashtu që në afërsi të Qendrës së Votimit, në një distancë më të afërt se 100 metra, është i vendosur poster i kandidatit të Lidhjes Demokratike e Kosovës (LDK) Hasan Qyqalla.

Në fotografi shihet vetëm poster i ndërsa qendra e votimit nuk shihet, nuk ka mundësi nga një fotografi e tillë të identifikohet qendra e votimit, dhe si rrjedhojë në pamundësi të identifikimit të qendrës së votimit, është e pamundur të përcaktohet distanca e kërkuar me ligj.

Po ashtu nga fotoja e ofruar nuk mund të identifikohet në mënyrë të qartë dhe bindëse se është ndonjë objekt i përcaktuar për QV, dhe nëse e njëjta është duke u shfrytëzuar për të votuar si Qendër e Votimit.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë nenin 117 dhe 118 par. 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Anr.445/2021 më datën 15.02.2021

Kryesues i Panelit
Ferki Xhaferi



Këshillë juridike: *Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.*